



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në vazhdimin e parë të seancës së pesëdhjetë e shtatë të mbajtur më 21.12.2021 miratoi

Vendim

Procedura për kontrollimin e fletës anketuese të _____, ish-drejtor i Fondit të _____ Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-1949/1 datë 14.05.2020.

Lënda me numër 08 –1949/1 të datës 14.05.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-1949 / 1 nga 14.05.2020 për kontrollimin e fletës anketuese të _____, ish-drejtor i Fondit për _____ të Republikës së Maqedonisë së Veriut është formuar sipas denoncimit në mënyrë elektronike.

Pas mbikëqyrjes së realizuar në evidencë, KSHPK-ja konstatoi se personi _____ brenda afatit të përcaktuar me ligj prej 30 ditësh pas hyrjes së mjeteve (80,000.00 AUD) në llogarinë valutore në NLB Bankë nuk ka dorëzuar formularin për raportimin e ndryshimit të pasurisë në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

KSHPK-ja ka përgatitur raport për kundërvajtje dhe urdhërpagesën e konstatuar dhe ia ka dorëzuar personit _____. Më 20 prill 2021 ka paguar gjobën në shumën e shënuar në urdhërpagesë për kundërvajtje dhe dëshminë e pagesës e ka dorëzuar në KSHPK të regjistruar me numër 08-1363/2 nga 24.04.2021.

KSHPK, pas shqyrtimit të lëndës, konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtejshëm kompetent në rastin konkret.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.



Miratoi: Goran Trpenoski, anëtar

КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР
ПЃР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
КРЈЕТАР,
Biljana Ivanovska